



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 602/3 prot

Tiranë 23.02.2024

Lënda : Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve për procedurën e konkurrimit
“ Pranim në shërbimin civil gjyqësor “

Në zbatim të nenit 57, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 9 dhe 17, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor datë **22.02.2024** për dorëzimin e dokumentave personale për pozicionin e lirë dhe nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të kandidatit, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të shpallura për konkurrim, sipas procedurës “ Pranim në shërbimin civil gjyqësor” Kancelari i Gjykatës së Lartë për pozicionin e shpallur në njoftimin e datës 01.02.2024 njofton se :

I. Për konkurrimin sipas procedurës “ Pranim në shërbimin civil gjyqësor” për :

- **1 (një)** vend vakant në pozicionin “Specialist prokurimesh - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse”, (kategoria ekzekutive, IV-1) , kandidati i kualifikuar për të vazhduar në fazat pasardhëse të konkurrimit të hapur është kandidatja :

Zj.Zenepe Alla

Provimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e Gjykatës së Lartë më datë **29.02.2023**, ora **13.00**.

KANCELARI NË DETYRË

ANILA KULO

